



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 9222 Prot.

Roskovec, më 26.11 2024

VENDIM

NR 67. DATE 25.11.2024


**"PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË KËSHILLIT  
BASHKIAK PËR MUAJIN TETOR 2024"**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", si dhe Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec neni 88, Këshilli i Bashkisë,

**VENDOSI :**

- 1- Miratimin e procesverbalit të mbajtur më datë 28.10.2024, në mbledhjen e Këshillit Bashkiak për muajin Tetor 2024.
- 2- Ngarkohet Sekretari i Këshillit me zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 80189/1 Prot.

Roskovec, më 29.10.2024

Procesverbal Nr.11

-I mbajtur sot, datë 28.10.2024, ora 13<sup>00</sup>, në mbledhjen e Këshillit të Bashkisë, mbledhje e radhës, me rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Shtator 2024.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.
4. Për zëvendësimin e vakancës në Komisionet e Përherëshme të Këshillit Bashkiak.
5. Për dhënien e Ndihmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-30 Shtator 2024.
6. Për shpronësimin për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga projekti "Rritja e sigurisë së digës dhe përmirësimi i aftësisë ujëmbledhëse të Rezervuarit të Kurjanit".
7. Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Ora e hapjes së mbledhjes: 13<sup>10</sup>

Këshilltarët prezent: A.Plaka, A.Lamaj, E.Çepele, Rr.Hazizi, F.Hoxha, L.Goga, E.Buzi, E.Kaçeli, N.Zeka, H.Hajdini, A.Hoxha, A.Pelo S.Bibo Qamili, Zh.Metushi, E.Toska.

Këshilltarët që mungojnë: E.Xhaxhaj, Dh.Malka, J.Begaj, P.Toro, V.Çepele, F.Feleqi.

Prezent nga bashkia: Nënkyetari M.Goga, P/Zbatueshmërisë së Investimeve A.Dukaj, P/Shërbimit Social S.Saliaj.

Me plotësimin e kuorumi, Kryetari hap mbledhjen. Prezent në fillimin e mbledhjes janë 12 këshilltar. Kryetari – faleminderit të gjithëve që jeni bërë pjesë e kësaj mbledhje. Për sa kohë kuromi i nevojshëm 12 nga këshilltarët janë të pranishëm, në cilësinë e Kryetarit të Këshillit e deklarojë të hapur mbledhjen e datës 28.10.2024. Ftoj këshilltarët, pasi në rendin e ditës nuk kemi asnjë ndryshim nga rendi i ditës i shpërndarë tek ju në datën 22.10.2024.

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.

Kryetari hedh në votim rendin e ditës dhe miratohet unanimisht me 12 vota pro.

2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Shtator 2024.

Në këtë moment vjen këshilltari Rr.Hazizi. Prezent 13 këshilltar. Elmazi-unë mendoj që nga pikë 1 deri tek pikë 3 nuk ka pse të lexohen, procesverbali të cilat ne i kemi, dhe i kemi lexuar. Sekretarja e Këshillit sqaron informacionin në lidhje me vendimet e miratuara mbledhjen e kaluar. Nga

vendimet e miratuara dy prej tyre ishin vendime me karakter normativ, të cilat i dërguam në Prefekturë për verifikim ligjor. Të dy vendimet janë miratuar nga Prefektura.

### 3.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.

Hidhet në votim procesverbali i mbledhjes së kaluar dhe miratohet unanimisht me 13 vota pro.

### 4.Për zëvendësimin e vakancës në Komisionet e Përherëshme të Këshillit Bashkiak.

Kryetari-ashtu sikundër ju e dini, jemi përballë rastit kur njëra nga këshilltaret është larguar nga Këshilli Bashkiak dhe këshilltarja e re në bazë të rregullores automatikisht vendoset në të njëjtat pozicione që ka mbajtur këshilltarja e parë në Komisionet e Këshillit Bashkiak. Për këtë arsyje paraqesim projekt-vendimin për zëvendësimin e vakancës në Komisionet e Përherëshme të Këshillit Bashkiak. Komisioni për Zhvillimin Urbanistik dhe Ndërtimet, Kryetari lexon emrat si ishte dhe si bëhet sipas projekt-vendimit të paraqitur. Pra Aleksandra Lamaj zë vendin e Esmeralda Musko. E njëjtë gjë është sa i takon Komisionit për Mbrojtjen dhe Shëndetin Publik ku përsëri Esmeralda Musko është larguar dhe ka pas pozicionin e Zëvendëskryetares, pozicion të cilin automatikisht e merr znj.Aleksandra Lamaj, e cila ka zëvendësuar znj.Esmeralda në këtë Këshill të nderuar. Pas miratimit të këtij projekt-vendimi ngarkohet Sekretaria e Këshillit dhe Komisionet e Përherëshme përkatëse për zbatimin e tij. Nuk ka pyetje dhe diskutime për këtë projekt-vendim. Kryetari e hedh në votim projekt-vendimin sipas materjalit të paraqitur dhe miratohet unanimisht me 13 vota pro. Kryetari dhe këshilltarët i urojnë suksese znj.Aleksandra. Në këtë moment vijnë këshilltarët E.Toska, Zh.Metushi, prezent tanë në sallë 15 këshilltarë.

### 5.Për dhënien e Ndihmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-30 Shtator 2024.

Kryetari-fton specialisten për relatimin e këtij projekt-vendimi. Amarildo-Kryetar ka mundësi, pasi ajo nuk ka ndryshime mos e mundo kot, kështu e mendojmë ne. Ermira-jemi plotësisht dakort. Elmazi-jam dakort me mendimin e Amarildos. Kryetari-atëherë për sa kohë është shqyrta paraprakisht nga këshilltarët materjali dhe nuk ka nevojë për sqarime apo diskutime shtesë në lidhje me këtë projekt-vendim, nuk më ngelet gjë tjetër veçse tju kërkoj të votojmë për këtë projekt-vendim. Kryetari e hedh në votim projekt-vendimin sipas materjalit të paraqitur dhe miratohet unanimisht me 15 vota pro.

### 6. Për shpronësimin për interes publik,të pasurive të paluajtshme,pronë private që preken nga projekti “Rritja e sigurisë së digës dhe përmirësimi i aftësisë ujëmbledhëse të Rezervuarit të Kurjanit”.

Kryetari-fton specialistin për të relatuar për projekt-vendimin. Dua tju njoftojë se përpara ardhjes në sallën e Këshillit të këtij projekt-vendimi, është bërë dhe dëgjesa publike në zbatim të detyrimit të ligjit. Maksi-nga ana e Nënkyretares së Këshillit që ka qënë prezent, i është bërë ftesë të dy pjesmarrësve që kanë interes për problemin e projekt-vendimit në fuqi që do diskutohet, për të marr pjesë në mbledhjen e Këshillit. Znj.Mira Buzi u ka bërë ftesë për të ardhur në mbledhje. Arben Dukaj sqaron projekt-vendimin të cilin e prezanton edhe në video-monitor. Në pozicionin e anëtarit të Komisionit të Shpronësimit për pronën që shpronësohet për investime publike, siçjeni në dijeni rezervuari i Kurjanit ka një problem me mbushjen e rezervuarit, duke parë që periudha hidrike dhe e nxehëtë, kemi problem që rezervuari i Kurjanit ka disa vite që nuk arrin të mbushet në kuotën e duhur. Rezervuari i Kurjanit është ndërtuar në vitin 53 dhe kapaciteti ujëmbajtës i rezervuarit ka qënë 35 milion m<sup>3</sup> ujë. Regjimi hidrik i këtyre viteve të fundit na nxjerr me shumë

diferencia. Rezervuari i Kurjanit ka qënë i furnizuar nga stacioni i pompës së Matkës, ndryshimet që ka pësuar gjatë viteve, një nga objektet që u shkatërrua është dhe stacioni i Matkës dhe lind e domosdoshme ndërtimi i stacionit të ri të Matkës, por stacioni i ri i Matkës ka një devijim të vogël nga gjurma e parë, se më përparrar furnizimi me ujë bëhej nga stacioni i Goriçanit, tanë furnizimi me ujë do bëhet nga stacioni i pompës së Hoxhenjve në Suk. Stacioni i Hoxhenjve është ndërtuar para 6-7 vitesh, dhe njëkohësisht do ndërtohet dhe stacioni i Matkës. Nuk mund të furnizohet rezervuari i Kurjanit nga sasia e ujit që është në kënetë, prandaj e do patjetër një ushqyes, është stacioni i Hoxhenjve që do të punojë vazhdimisht për të furnizuar kënetën, dhe pas ndërtimit të stacionit të Matkës, do të furnizojë rezervuarin e Kurjanit. Pak a shumë e keni parasysh se ku është stacioni i Hoxhenjve, nëpërmjet kanalit V30 do bëhet ushqyesi, është ekzistues. Problemi që lind është për shpronësimin tek stacioni i pompës së Matkës për arsyen se aty do shpronësohen 7 dynym tokë që janë në pronësi të Ilir Gega dhe Sali Gega. Ky shpronësim bëhet për arsyen të ndërtimit të stacionit të paneleve diellore, nuk kemi mundësi që për 365 ditë të furnizohet stacioni i Matkës me energji elektrike, prandaj është i domosdoshëm ndërtimi i stacionit të Matkës. Një sqarim paraprak, edhe tek stacioni i Hoxhenjve do të ndërtohen panele diellore, që e kemi fituar, pra jemi përfitues nga Gizi gjerman, pompat do të punojnë nëpërmjet paneleve që e kemi fituar nga Gizi gjerman, ndërsa ne marrim përsipër, buxheti i shtetit jo ne, që të ndërtohet stacioni i Matkës dhe aty do të ndërtohet stacioni i paneleve diellore për furnizimin me energji elektrike të stacionit të Matkës. Prandaj ka lindur e domosdoshme shpronësimi. Aty faktikisht në projekt janë parashikuar 8 dynym tokë, por 1 dynym është në administrim pronë e bashkisë, lind e domosdoshme shpronësimi i këtyre dy familjeve me 7 dynym tokë. Vlera e shpronësimit është sipas materjalit që ju keni, çmimi i tokës për  $m^2$  është e përcaktuar sipas VKM-së së 2016, ku është përcaktuar harta e re dhe çmimi për  $m^2$  për çdo zë kadastral, tokë arë apo truall, pyjore, kullotë. Amaraldo-meqënëse kemi dhe specialistin këtu, një pyetje kisha. Me ndryshimet që do bëhen, do ketë përmirësim në furnizimin me ujë përvaditje fermerëve? Sepse dimë që liqeni ose rezervuari kohët e fundit nuk ka arritur ti përbushi kërkesat që kanë nevojë për ujë fermerët, për të vaditur kulturat e tyre bujqësore. Arben Dukaj- siç e theshtë regjimi hidrik ka një ndryshim shumë të madh me vitet paraardhëse, dhe sasia e reshjeve që vijnë nga natyra janë shumë të pakta. Ne e kemi parë të domosdoshme ndërtimin e këtij stacioni duke e marr ushqyesin nga lumi Seman, projektimin e ka bërë një nga studiot më të mira që e njeh mirë këtë zonë, dhe shpresojmë që me ndërtimin e këtij stacioni, ushqyesit të rezervuarit të Kurjanit, shpresojmë që do të jetë një zgjidhje përfundimtare për problemin e digës për rezervuarin dhe për zonën përreth. Amaraldo-një pyetje tjeter kisha meqënëse është dhe Nënkyetari në cilësinë e përfaqësuesit të bashkisë, për dy zotérinjtë në fjalë që do shpronësohen, a janë kontaktuar zyrtarisht, dhe tokat e tyre sot çfarë kulturash kanë? Si do bëhet shpronësimi, në bazë edhe të kulturës që kanë mbjellë, se aty mund të ketë ullishte, nuk e di sjam i informuar, dhe a janë dakort ata me vlerën e shpronësimit? Maksi-në dëgjesën publike që zhvilluan në bazë të ligjeve në fuqi, kanë qënë prezent dhe ata që do shpronësohen për pjesën e paneleve diellore, njëkohësisht dhe ata pjestar ku do kalojë tubacioni. Në projekt-vendimin që ke përparrë është e përcaktuar shpronësimi i tokës arë, me vlerën nuk janë dakort, kuptohet që ata kërkojnë vlerën e tregut, por sipas ligjeve në fuqi jemi të detyruar të pranojmë vendimin e komisionit të shpronësimit të pronave të republikës, të Ministrisë përkatëse dhe pastaj kanë të drejtën e tyre të vazhdojnë me gjyq. Ne jemi brenda ligjit që të bëjmë shpronësimin sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave. Amaraldo-kjo duhet ndryshuar Maksi, sepse të gjithë e dimë që kjo nuk është vlera reale e tokës së tregut, me aq lekë a e merr diku atë pronë që ka ai zotëri, me atë shpronësim? Maksi-jo nuk e merr dot, nuk është me çmimin e tregut, dhe në shpronësimet e para që ne kemi bërë, po të njëjtën rrugë kemi ndjekur, pasi miratohet në komisionin shtetëror të pronave të vendimit përkatës, atëherë kanë të drejtën të ankimojnë në organin e gjykatës për të kërkuar çmimin e tregut. Janë disa praktika që janë bërë. Rrapi-ta ankimojnë por se fitojnë dot. Arben Dukaj-unë kam qënë në grupet e punës për të gjitha shpronësimet që janë bërë dhe njëkohësisht i kam ndjekur dhe procedurat në gjyq. Vërtet kanë qënë gjithë ata qytetar që janë shpronësuar, dhe pjesa dërrmuese e tyre e kanë kundërshtuar vlerën, por vlera është e panegociueshme me vendim qeverie, dhe pjesa dërrmuese e ka humbur gjyqin.

Amarildo-duhet të ndryshojë VKM-ja. Arbeni-nuk e ndryshojmë dot, ne jemi koshient që vlera e përcaktuar për m<sup>2</sup> është shumë e ulët, për të gjithë republikën. Amarildo-të gjitha bashkitë duhet të bëjnë diçka, duhet të mblidhen dhe në varësi të bashkisë caktojnë shpronësimin me një vlerë tjetër. Arbeni-ne e kishim detyrim ligjor për ti kërkuar ZRPP-së ose ASHK-së sot për kontratat e 3 muajve të fundit. Asnjë kontratë nuk ka për shit-blerje toke në Roskovec që ta merrnim si referencë, për të bërë një rilogaritje ose për tja kërkuar Agjencisë së Shpronësimit një vlerë të tillë. Ne jemi të detyruar të zbatojmë VKM-në e 2016 ku është miratuar harta dhe çmimi. Elmazi-për tua marr këtyre të dyve tokën është e lehtë sepse është Vendimi i Këshillit të Ministrave dhe e merr bashkia, dhe e merr me çmimin që është vendosur me 2600 lekë, për ta shitur e shet me 40 e ca mijë lekë, po bashkia jonë mirë pushteti qëndror, po pushteti lokal a ka mundësi që këta dy njerëz ti transferojë dhe tu japi tokë në vend tjetër? Sepse nuk është tokë e këtyre të dyve në gjykimin tim personal, por është tokë e fëmijëve, e brezave që do të vijnë, që do të ushqehen dhe do të punojnë në atë tokë. Nuk është thjesht se po ua marrim këtyre ne dhe po i spostojmë se është shteti, se shteti mi ka marr mua 140 hektar, e sot e kësaj dite smi ka dhënë, po ky është pushteti qëndror nuk është pushteti lokal, po tanë pushteti lokal a ka mundësi që ti sistemojë këta? Maksi-në një takim që kemi pasur me Këshillin Konsultativ të miratimit të projekt-vendimeve, projekt-ligjeve që është ngritur pranë Këshillit të Ministrave, sot jemi përpara faktit që është gati projekt-vendimi, projekt-ligji i cili do të miratohet pér transferimin e pronave dhe kompensimin e tokës që merret, pronave në tërësi jo vetëm tokës, që merret nga bashkia, dhe para këtij Këshilli po jua them sinqerisht që sipas atij vendimi apo projekt-ligji që do dali, do të jemi përsëri përpara jush pér tju dhënë përgjigjen e duhur. Sot nuk ka as nga bashkia as nga Vendim i Këshillit të Ministrave, ka vetëm një ligj të kompensimit të ish pronarëve me tokë bujqësore, pér këto që shpronësohen nuk ka ligj. Kryetari-unë kisha dy pyetje. 1. Nga kush do të përballohet vlera e kompensimit pér këta qytetar sepse në projekt-vendim e kemi të shënuar që do të përballohet nga buxheti i shtetit. Maksi-këtu Kryetar ke plotësisht të drejtë, në projekt-vendim është shkruar nga buxheti i shtetit ndërsa në buxhetin e miratuar pér shpronësimet në vitin 2024 nga ana juaj, është brenda buxhetit të bashkisë Roskovec dhe është i miratuar, prandaj nuk ka nevojë pér vendim tjetër, se shuma përkatëse 25 milion lekë të vjetra është brenda fondit 100 milion që kemi pér shpronësimë, të cilin e kemi miratuar në Këshillin e Bashkisë. Arbeni-është nga buxheti i bashkisë. Sekretarja e Këshillit-pra vendimi i zbardhur do të jetë nga buxheti i bashkisë. Kryetari-pyetja tjetër, besoj se jo vetëm unë por shumë nga këshilltarët sot këtu jemi përballë një vendimi shumë të vështirë, sepse kemi nga njëra anë një interes shumë të lartë publik, këto pompa do të shërbejnë pér të furnizuar me ujë në mënyrë të pérherëshme ujëmbledhësin e Kurjanit, dhe nëse kjo do të zgjidhej përfundimisht do të përmirësoj dukshëm nevojat pér ujë që ka fusha, që varet pér vaditje nga liqeni i Kurjanit, dhe kjo është shumë e thjeshtë pér tu kuptuar. Por nga ana tjetër kemi qytetarët të cilët ne po i shpronësojmë sot me një vlerë e cila është shumë larg vlerës së tregut sa njohim, me sa mundësi kemi pér ti njohur. Pyetja do fillonte nëse do kishim një lloj mënyre alternative pér të bërë shpronësimin e tyre, siç mund të ishte këmbimi, por u tha këtu që nuk është kjo mundësi. Do doja të ngrija një pyetje të tillë, në qoftë se këta qytetar nuk janë dakort me vlerën dhe i drejtohen institucionit të bashkisë me një kërkësë pér ti mbajtur ata parasysh, në qoftë se kjo zgjidhje mund tu jepet në një kohë të mëvonëshme, pér sa kohë sot, sa dim dhe sa ka ligj nuk lejohet që të bëhet një veprim i tillë, pra kompensimi mbase me një sipërfaqe të njëjtë toke brenda territorit të bashkisë, ekziston mundësia që këta të mbahen në konsideratë, që në momentin që del një hapsirë ligjore, këta të vlerësohen në këtë mënyrë? Gjithmonë nëse nuk pranojnë që të marrin vlerën e përcaktuar, se nëse pranojnë kjo procedurë mylllet këtu. Maksi-sot jemi përpara faktit të tillë, është pjesa e legjislacionit shqiptar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave pér shpronësimet, shumë shpejt e thashë është ky projekt-vendimi i ri që ka kaluar në Këshillin Konsultativ të projekt-ligjeve dhe projekt-vendimeve të Këshillit të Ministrave, dhe jemi përpara jush si Ekzekutiv dhe me kërkësën tuaj, pér të qënë të hapur përpara diçkaje që po të na duhet në rrugët në vazhdim, hap pas hapi ne jemi të hapur pér çdo lloj alternative tjetër. Kuptohet që hapi i parë i tyre është të bëjnë kundërshtimin me vendim gjykate, në qoftë se është vendimi i gjykatës kuptohet është i zbatueshëm. E dyta në qoftë se ata

nuk pranojnë dhe është baza ligjore në atë kohë që ata nuk pranojnë, jemi të hapur për ta sjellë në Këshill. Arbeni-duke parë realitetin që jemi, në këto kushte që jemi sot, ata nuk mund të kompensohen nga kjo sipërfaqe në një sipërfaqe tjetër, për arsyen se ligji 7501 është anulluar, nuk mund të zbatohet sot. E dyta nuk ka komision edhe sikur të ketë toka të lira, dhe është e pamundur në kushtet që jemi sot që ata të spostohen nga një sipërfaqe në një sipërfaqe tjetër. Këtë e kam nga përvoja e punës që kam punuar nga 7 vjet tek Komisioni i Verifikimit të Titujve të Pronësive, ligji 7501 është shfuqizuar, nuk mund të zbatohet asnjë pikë e këtij ligji për ndarje sot. Leksi-vërtet komision nuk ka për ndarjen e tokave, por para disa vitesh kur ka qënë Kryetar bashkie Gëzimi, u ndan disa toka që u dhanë ndoshta me qera 99 vjet, nuk e di mirë, dhe ai nuk e bazoi në ligj? Siç e bëri ai mund ta bësh kompensimin me këta. Arbeni- në atë kohë që ka qënë Gëzimi Kryetar bashkie është zbatuar ligji për kalimin e tapive të ish-fermerëve që e kishin në përdorim, unë kam qënë pjesë e komisionit qeveritar në atë kohë dhe Drejtori i Komisionit të Verifikimit të Titujve të Pronësisë në Prefekturën e Fierit. Unë kam qënë iniciatori i komisionit qeveritar në atë kohë, për problemin e tapive që ishin në përdorim nga ish fermerët. Me 7501 dhe udhëzimin 452, fillimisht toka është dhënë në përdorim për të gjithë fermerët, pastaj kaluan me kalimin e tapive ose aktin e marrjes së tokës në pronësi, nuk jam shumë i saktë me shifrat se unë kam pasur gjithë Qarkun e Fierit, dhe pjesa dërrmuese rrreth 70-80% e fermerëve që janë trajtuar me tokë, ishin pa kaluar në pronësi, dhe lindi e nevojshme që të dal ky ligj, për ti kaluar nga përdorimi në pronësi. Në atë kohë komisioni që përgatiste dokumentacionin nga bashkia, për kalimin nga përdorimi në pronësi, është zbatuar shumë pak jo vetëm në bashkinë e Roskovecit, por në të gjithë territorin dhe pak kush e ka marr prapë me atë procedurë, pak kush e ka marr tokën në pronësi, dhe sot pjesa dërrmuese e tapive janë në përdorim. Dhënia e tokës me qera ka dhe një kusht tjetër, që ta japësh tokën me qera duhet ta kesh me çertifikatë, që të shesësh diçka duhet të kesh pronësinë, nëse ske pronësinë nuk të njeh askush për pronar, dhe bashkia po të ketë toka me qera duhet e domosdoshme që ti ketë në pronësi, që të bëj aktin notarial tek noteri për çdo veprim. Por ligji ka qënë për kalimin e tokës nga përdorimi në pronësi. Ska me pyetje dhe diskutime. Kryetari e hedh në votim projekt-vendimin me ndryshimin e përmendor më sipër, që financimi do të përballohet nga buxheti i bashkisë, dhe miratohet me 13 vota pro (3/5),2 vota abstenim A.Hoxha,A.Pelo. Miratohet.

## 7.Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Rr.Hazizi largohet në këtë moment.Elmazi-sa kaluam një vendim të rëndësishëm në Këshillin Bashkiak, i cili na mbulon 500 e ca hektar tokë bujqësore për të vadir, por unë kërkoj diçka nga bashkia që të paktën ne po bëjmë 8 vjet, dhe në kanalet e treta të cilat ne në Këshillin Bashkiak kemi kaluar për të bërë me 50 lekë të vjetra për m/linear për të pastruar, dhe në një kohë që bashkia i ka skrepat, duke filluar nga 8/1 tek 8/8, duke filluar nga 7/1 deri tek 7/7 nuk është bërë asnjë investim. E dyta tek rrugët për në blloqe na latë si në mesjetë, gjithmonë rrugët e blloqeve nuk janë bërë, të hysh në bllok vritesh, unë e kam 1000 metër të shkoj në fund tek argjinatura, nuk shkon dot, e kam ngritur disa herë në Këshill dhe nuk është bërë. I nderuar Kryetar, rruga që shkon për në Jagodinë, rruga e dytë tek shtepia e Refit Vrapit e deri tek ura e Jagodinës, e karikoni të paktën, mirë mundësi për të bërë ska por karikoje që të shkojnë njerzit të paktën me mjetet e tyre bujqësore, që të punojnë në ara. Maksi-në mbledhjen tjetër do ta japim informacionin me shkrim. Leksi-unë ngrita shqetësimin për pjesën e investimit që bëri ujësjellësi dhe rehabilitimin e atyre kanaleve, na u kthyje një përgjigje vetëm duke treguar emrin e firmës se kush e ka bërë, por nuk është se u dha ndonjë zgjidhje se çfarë do bëhet për arsyen sepse korigimet që kanë bërë ata, nuk i kanë kthyer në gjendjen e mëparshme rrugët që kanë qënë të asfaltuara. Në pjesën më të madhe të tyre është një investim për të ardhur keq, dhe unë habitem dhe nuk e di se kush është ajo firmë që e ka marr përsipër për të bërë një punë të tillë. Në rast se është marr në dorëzim është një minus i madh. Arbeni-shqetësimi i këshilltarit është shumë i drejtë, është një investim që është realizuar për përmirësimin e ujësjellësit të Roskovecit, janë bërë punime në 2020,2021. Në projekt kanë qënë që tubot do shtrihen në tokë, prerjen e rrugëve, hapjen e kanaleve por ka qënë dhe kthimi në gjendjen e mëparshme. Realisht është bërë një riparim gjatë beharit, ka ca rrugë që nuk kanë sjellë

ndonjë përmirësim të dukshëm, dhe ju është bërë shkresa se janë 3 kompani që e kanë bërë këtë investim, nuk është marr në dorëzim. Leksi-është për të ardhur keq, është bërë me primitivitet të madh punimet atje. Arbeni-është dhe diçka që të jemi korrekt, është shumë e vështirë që të arrihet cilësia e mëparshme. Leksi-kemi parë dhe investimet në Patos dhe në Fier, nuk e çojnë në gjendjen e mëparshme, por të paktën jo ashtu xhunga-xhunga sikur i kanë hedhur me dorë. Spo flas tek Unaza Perëndimore që atje skanë bërë gjë fare sepse nuk është e shtruar rruga, por të paktën këtu që duket, nëpër rrugët e qytetit. Arbeni-i kam parë me shumë vëmendje, nuk është bërë aktmarrja përfundimtare. Ska më diskutime. Kryetari-i falenderon të gjithë që ishin pjesë e kësaj mbledhje dhe e deklaron mbledhjen të mbyllur.

Sekretar

Arlinda Hajdini



Kryetar

Afrim Plaka

